

REPUBLIKA E SHQIPÉRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKT VENDIM

Nr. _____, datë _____

PËR

MIRATIMIN E RREGULLAVE, PROCEDURAVE DHE KRITEREVE TË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PËR NJË JETESË TË PAVARUR PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 6, të Ligjit Nr. 93/2014, "Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara", me propozimin e ministrit së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave, procédurave dhe kritereve të ofrimit të shërbimeve për një jetesë të pavarur për personat me aftësi të kufizuar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Kulturës dhe njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

EDI RAMA

KRYEMINISTRI

RREGULLAT, PROCEDURAT DHE KRITERET TË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PËR NJË JETESË TË PAVARUR PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR

KREU I.

PËRKUFIZIME

1. "Persona me aftësi të kufizuara", në kuptimin e këtij vendimi janë, "individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët".
2. "Jetesa e pavarur", siguron përfshirjen sociale të personave me aftësi të kufizuara, zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjtë me të tjerët, kur është nevoja, nëpërmjet ofrimit të mbështetjes dhe të ndihmës, bazuar në zgjedhjen dhe aspiratat e vetë individit.
3. "Shërbimet e jetesës së pavarur për personat me aftësi të kufizuar", janë shërbime që ofrohen për rritjen e mundësive për zgjedhje të barabarta dhe liri të barabarta me personat e tjerë në shoqëri për përfshirjen dhë integrimin social nëpërmjet vendimeve individuale.
4. "Koordinator mbështetës" për shërbimet e jetesës së pavarur është specialist në fushën e shërbimeve sociale dhe aftësisë së kufizuar në nivel vendor.
5. "Përshtatje e arsyeshme", në kuptimin e këtij projektvendimi është modifikimi dhe rregullimet e nevojshme e të përshtatshme, atëherë kur është e nevojshme, pa vodosur barrë të tepruar në mjedisin e punës.
6. "Plani individual i mbështetjes për jetesë të pavarur", është plani që përmban shërbimet e jetesës së pavarur, që ofrohen për personat me aftësi të kufizuar, në nivel vendor që mbështesin jetesën e pavarur për personin me aftësi të kufizuar, zhvillimin e njohurive dhe aftësive për pavarësinë, autonominë dhe fuqizimin e tij.

KREU II

RREGULLAT TË PËRGJITHSHME TË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PËR NJË JETESË TË PAVARUR

1. Shërbimet për jetesë të pavarur përshtaten dhe ofrohen nga çdo subjekt publik apo jopublik që ofron të mira dhe shërbime për publikun, duke përfshirë institucionet e pavarura, institucionet e administratës shtetërore, bashkitë dhe qarqet.
2. Institucionet të cilat ofrojnë shërbime ekzistuese për PAK duhet të garantojnë lehtësi dhe akses për shërbime në funksion të jetesës së pavarur për të garantuar pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat e jetës, sipas fushë-veprimtarisë së tyre.
 - i) Strehim;

- ii) Transport;
- iii) Shëndetësi;
- iv) Kujdes social;
- v) Arsimim;
- vi) Punësim.

3. Këto shërbime:

- a. Trajtonë nevojat e individit me aftësi të kufizuar, duke respektuar të drejtat dhe dëshirat e tyre.
 - b. Ofrojnë mundësi për zgjedhje dhe autonomi në jetën në komunitet për Personat me Aftësi të Kufizuar PAK.
 - c. Mbulojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha sferat e jetës, përfshirë sferën e punësimit, arsimit dhe aktiviteteve shoqërore, profesionale dhe të kohës së lirë.
 - ç. Marrin në konsideratë të gjitha dëmtimet e nevojat për ndihmë që rrjedhin nga dëmtimi/aftësia e kufizuar;
 - d. Respektojnë të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të udhëzuar ndihmësin personal.
4. Shërbime për jetesë të pavarur që ofrohen nga subjektet publike dhe private për Personin mne Aftësi të Kufizuar, koordinohen nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale në bashki/qarqe, sipas planit individual të mbështetjes (PIM), Aneksi nr.1.
5. PIM-i hartohet një herë në vit kalendarik. Mbledhja për PIM-in mbahet jo më herët se 90 ditë nga data e hyrjes në fuqi të planit të ri.

KREU III.

KRITERET DHE PROCEDURA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PËR JETESË TË PAVARUR

- 1. Shërbimet e jetesës së pavarur ofrohen pwr Personat me Aftësi të Kufizuar të vlerësuar me vendime të komisioneve multidisiplinare të vlerësimit të aftësisë së kufizuar të përcaktuar në nenin 10, të Ligjit Nr.93/2014 për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara që kërkojnë shërbime.
- 2. Shërbimet e aksesueshme për jetesë të pavarur përcaktohen sipas legjisacionit në fuqi për aksesueshmërinë dhe realizohen në mënyrë progresive.
- 3. Kriteret e përzgjedhjes së ndihmësit personal janë parashikuar në legjisacionin në fuqi për ndihmësin personal.
- 4. Ofrimi i pajisjeve e mjeteve teknike mbështetëse realizohet në mënyrë progresive nga ministritë e linjës dhe Fondi i Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor.
- 5. Procedura për përfitimin e shërbimeve të përshtatjeve të arsyeshme në të gjitha fushat e përmendura në pikën 1, Kreu II është si vijon:

a) Përshtatja e arsyeshme është detyrim ligjor për të gjitha subjektet e parashikuara në pikën 1 të Kreut II të këtij vendimi.

b) Sektorët e shërbimeve të brendshme, ose në mungesë të tyre, sektorët që kryejne funksionet e tyre në institucione private koordinojnë punën për zbatimin e rregullave, kritereve dhe procedurave të përcaktuara në këtë vendim.

c) Kërkesa shprehet në fjalë ose me shkrim tek të gjitha subjektet e përcaktuara në pikën 1, Kreun II të këtij vendimi nga personi me aftësi të kufizuar, përfaqësuesi i tij, mbështetësi në vendimarrje ose/dhe ndihmësi personal.

ç) Gjatë shqyrtimit të kërkesës, subjekti që ka detyrimin për të garantuar përshtatjen e arsyeshme, ka detyrimin të vlerësojë nëse përshtatja e arsyeshme përbën barrë të tepruar.

d) Subjekti kryen një vlerësim të kërkesës ku përfshihen:

- Natyra dhe kostoja e përshtatjes së nevojshme;
- Burimet financiare të ndërmarrjes që duhet të sigurojë përshtatjen e arsyeshme për efekt punësimit dhe trajnimi;
- Efekte që mund të japid shpenzimet apo burimet financiare ose impakti që mund të ketë kjo përshtatje në funksionimin e ndërmarrjes;
- Llojet e veprimtarive që kryhen, përfshirë përbërjen, strukturën, fuqinë punëtore, largësia nga vendodhja, marrëdhënien administrative dhe fiskale që kanë, etj.
- Institucionet që kryejnë vlerësimin e përshtatjes së arsyeshme duhet të plotësojnë brenda 6 muaj kushtet e përshtatjes së arsyeshme.

6. Koordinimi i shërbimeve të jetesës së pavarur në bashki bëhet nga koordinatori i mbështetjes për personat me aftësi të kufizuar në nivelin e qeverisjes vendore.

7. Detyrat e koordinatorit të mbështetjes për shërbimet e jetesës së pavarur janë:

- a) Identifikon aktorët ofrues të shërbimeve publike dhe jo-publike për jetesën e pavarur
- b) Ofron informacion për shërbimet ekzistuese për jetesën e pavarur me shërbime të referimit.
- c) Vlerëson nevojat dhe dëshirat individuale ekonomike, sociale, të aftësimit dhe riaftësimit, arsimore, të formimit profesional e punësimit, të aktiviteteve sportive, shplodhëse e zbavitëse dhe pjesëmarjen politike, që janë thelbësore për jetesën në komunitet të personit me aftësi të kufizuar;
- ç) përgatitja e një plani individual të mbështetjes (PIM) bazuar në vlerësimin e mëparshëm;
- d) referimi dhe lidhja me institucionet dhe organizatat që ofrojnë shërbime që mundësojnë ndihmën ekonomike, zhvillimin e aftesive sociale, aftësimin dhe riaftësimin, arsimimin, formimin profesional e punësimin, aktivitete sportive, shlodhëse dhe zbavitëse, pjesëmarjen politike.
- dh) mbështetje me avokati për përfshirje të personit me aftësi të kufizuar në aktivitete e praktika gjithëpërfshirese sipas kërkesës së këtij të fundit;
- e) mbështetja për shërbimet e ndihmesës personale, dhe
- ë) mbështetja për vendimmarrje të mbështetur.
- f) harton dhe ndjek mbarëvajtjen e Planit Individual të mbështetjes në bashkëpunim me ofruesit e shërbimeve, i cili përmban aftësisë e shprehitë, njojuritë, cilësите, aktivitetet e parapëlqyera etj.; mjetet dhe pajisje ndihmëse të nevojshme; shokët, shoqet, anëtarët e familjes e të afërmit që

mund të ndihmojne në realizimin e objektivave; qendrë për aftësim e riaftësim profesional; shërbimet aftësuese dhe riaftësuese ne familje dhe komunitet, shërbimet e ndihmesës personale dhe të vendimmarrjes së mbështetur.

KREU IV

ANKIMIMI

1. Për rastet e mosofrimit të shërbimeve të jetesës së pavarur, çdo person me aftësi të kufizuar ka të drejtë:
 - a). Të ankohet te drejtiesi i subjekteve të parashikuara në pikën 1 të Kreut II të këtij vendimi në rast se konstaton se rregullat, kriteret apo procedurat e parashikuara në këtë vendim janë shkelur.
 - b). Të marrë informacion në çdo kohë në lidhje me trajtimin e ankesës dhe të marrë shpjegime në përgjigje të ankesës së tij.
2. Çdo subjekt i parashikuar në pikën 1, të Kreut II të këtij vendimi është i detyruar të shqyrtojë ankesën, në mënyrë efektive dhe brenda afati ligjore.
3. Kjo dispozitë nuk e kufizon të drejtën e ankimit në institucionet të tjera, sipas legjislacionit në fuqi, si Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit, ministria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar, bashkitë, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, gjykata, prokurori.

KREU V

KOORDINIMI DHE INSTITUCIONET E SHËRBIMEVE TË JETESËS SË PAVARUR KOORDINIMI NGA INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE

1. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me institucionet që punojnë me çështjet e aftësisë së kufizuar në institucionet qendrore dhe vendore kanë detyrimin që të koordinojnë punën për zbatimin e rregullave, kritereve dhe procedurave të përcaktuara për shërbimet e jetesës së pavarur.
2. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror të hartojë zhvillimin e programit të trajnimit dhe në bashkëpunim me bashkitë, organizimin e trajnimit të koordinatorëve të mbështetjes të jetesës së pavarur.
3. Ministria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar koordinon dhe monitoron ofrimin e shërbimeve të jetesës së pavarur në nivel kombëtar për PAK.
4. Çdo subjekt i përmendur në pikën 1, Kreu II, sipas nevojave të identikuara, ofron shërbime për personat me aftësi të kufizuara, ndihmë dhe mbështetje me synim realizimin e zgjedhjeve dhe pritshmërive të vetë individit me Aftësi të Kufizuarë për jetesën e pavarur.
5. Çdo bashki dhe komunë angazhon Drejtorinë e Shërbimeve Sociale për të koordinuar procesin dhe ngarkon një punonjës me detyrën e koordinatorit të mbështetjes.

Aneks 1**PLANI INDIVIDUAL I MBËSHTETJES (PIM) PËR JETESËN E PAVARUR**

Emer /Mbiemër	
Koordinatori Mbështetës	
Bashkia/Komuna	
Shërbimet aktuale që përfiton individi me AK:	

VLERËSIMI I NEVOJAVE PËR SHËRBIME PËR JETESË TË PAVARUR

Mbrojtje Sociale/Shëndetësi	
Arsim	
Strehim	
Punësim/Formim Profesional /përshtatje e arsyeshme	
Aftësi të jetesës së përditshme/aktivitete të përditshme	